



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2019:272278

Datë: 13.02.2025

Numri i dokumentit: 06849348

**C.nr.1975/2019**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtari Gëzim Shehu, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit R. (N) H. nga Prizreni, me numër personal ..... të cilin me autorizim e përfaqëson av. H.S. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, me objekt kontesti kompensimin e shpërblimit jubilar dhe pagat përcjellëse me rastin e pensionimit, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 13.02.2025, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit R. (N) H. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të *“DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit, që paditësit në emër të përcjelljes në pension t’ia paguaj-kompensoj tri (3) paga në vlerën e pagesës së fundit (564.01 x 3) gjithsej 1,128.02 euro, në emër të shpërblimit jubilar të tri (3) pagave mujore në shumën prej (564.01 x 3) gjithsej 1,692.03 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme të kërkesëpadisë në lartësi prej 2,820.05 euro, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe kompensimin e shpenzimeve procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e formës së prerë të aktgjyqimit, nën pasojat e ekzekutimit me detyrim”* si e **pa bazuar**.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

## **A r s y e t i m**

Fillimisht paditësi R. (N) H. të cilin me autorizim e përfaqëson av. H.S. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me datë 21.11.2019, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, me objekt të kontestit kompensimin e shpërblimit jubilar dhe pagat përcjellëse me rastin e pensionimit.

Në referatin e padisë ka theksuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në vendin e punës udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile pranë K.K. Prizren në kuadër të drejtorisë për Administratë deri më datë 27.09.2019 dhe sipas ligjeve të aplikueshme iu është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Paditësi R.H. ka përvojë pune 36 vite dhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës nuk ka gëzuar asnjë të drejtë për kompensimin e tri pagave mujore si shpërblim jubilar si dhe pagave mujore me rastin e pensionimit sipas mesatares së tri pagave të fundit të paraparë me Ligjin nr.03/L-147 neni 22 par. 2.2 dhe 2.3, rregulloren nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil neni 19 dhe 21.

I autorizuari i paditësit av. H.S. me parashtresën e datës 31.03.2021, e ka bërë precizimin e padisë në të cilën ka theksuar se e paditura Komuna e Prizrenit paditësit nuk ia ka kompensuar-paguar tre (3) paga në emër të shkuarjes në pension duke mos e zbatuar Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive e cila ka hyrë në fuqi më 01.01.2015, me të cilën sipas nenit 82, paditësi gëzon të drejtën në tri (3) paga përcjellëse për pension si dhe në emër të shpërblimit jubilar tri (3) paga në lartësinë e vlerës për tre muajt e fundit para pensionimit dhe atë në kuptim të nenit 53 të Marrëveshjes. Ka theksuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar për tri (3) paga përcjellëse për pensionim dhe tri (3) paga jubilarë ngase është e drejtë ligjore e paditësit në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e nënshkruar nga Qeveria e Kosovës dhe është në fuqi që nga data 01.01.2015, me të cilën në bazë të nenit 53, i punësuar në rastin e pensionimit e gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave mujore që i ka marrë për tre muajt e fundit si dhe tri (3) pagave jubilarë në bazë të përvojës së punës tek e paditura, andaj ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Më tej ka theksuar se pretendimet e paditësit për kompensimin e pagave përcjellëse dhe jubilarë bazuar në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më 01.01.2015, e që vlefshmëria e saj është tre vite nga momenti i hyrjes në fuqi dhe atë bazuar në nenin 90 para. 4 i Ligjit të Punës ku decidivisht thuhet se "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet", e që pas skadimit të këtij afati e njëjta nuk është vazhduar dhe e njëjta është jashtë fuqie, andaj si e tillë kërkesëpadia nuk ka bazë ligjore. Prandaj duket marrë parasysh thëniet si më lart i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë si të pabazuar padinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: vendimin e datës 01.10.2019 të Departamentit të Pensioneve, vendimin me nr. 01-118-

143355, të datës 07.10.2019, të lëshuar nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Prizrenit, përgjigjen e Komunës së Prizrenit, vërtetimin me nr. 02-117-147609/01, e datës 22.10.2019, të lëshuar nga Komuna e Prizrenit, vërtetimin me nr. 379, të datës 28.08.2019, të lëshuar nga Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, vërtetimin me nr. të protokollit 733, të datës 30.09.2019, të lëshuar nga Gjimnazi "Gjon Buzuku" në Prizren, librezën e punës me numër 113538, vërtetimin me nr. 02-120-162278/01, e datës 20.11.2019, të lëshuar nga Komuna e Prizrenit, konfirmimin dhe qarkullimin bankar të datës 20.11.2019.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjen në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga shiqimi i vendimit të datës 01.10.2019 të Departamentit të Pensioneve, gjykata ka vërtetuar faktin se është miratuar kërkesa e R.H. për njohjen e të drejtës në kategorizimin për pension kontributpagues të moshës.

Nga shiqimi i vendimit me nr. 01-118-143355, të datës 07.10.2019, të lëshuar nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Prizrenit, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit i sistemuar në vendin e punës Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile në kuadër të Drejtorisë për Administratë, i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me datë 27.09.2019.

Nga shikimi në përgjigjen e Komunës së Prizrenit, gjykata ka vërtetuar faktin se Komuna e Prizrenit e ka njoftuar paditësit se Ligji nr.06/L-114 për Zyratë Publik nuk specifikon kompensimin e tri pagave mujore për shkak të pensionimit.

Nga shikimi i vërtetimit me nr. 02-117-147609/01, e datës 22.10.2019, të lëshuar nga Komuna e Prizrenit, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka qenë në marrëdhënie punë në Komunën e Prizrenit i sistemuar në vendin e punës Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile në Drejtorinë e Administratës nga data 01.11.2000 deri me datë 27.09.2019.

Nga shikimi i vërtetimit me nr. 379, të datës 28.08.2019, të lëshuar nga Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës ka 3 vite përvojë pune.

Nga shiqimi i vërtetimit me nr. të protokollit 733, të datës 30.09.2019, të lëshuar nga Gjimnazi "Gjon Buzuku" në Prizren, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka punuar në Gjimnazin "Gjon Buzuku" në Prizren nga data 01.09.1996 deri me datë 31.08.2000, si mësimdhënës.

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie punë në Komunën e Prizrenit i sistemuar në vendin e punës Kordinator i Gjendjes Civile në Drejtorinë e Administratës. Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse ishte nëse paditësit i takon e drejta për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe pagat përcjellëse me rastin e pensionimit.

Me nenin 4 par.2 të Ligjit të Punës 03/L-212, i cili ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditësit parashihet se: *“Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”*. Ndërsa në nenin 67 të po këtij ligji parashihet se: *“1. Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: 1.4. kur i punësuarin e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç”*. Po ashtu në nenin 90 të këtij ligji parashihet se *“1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet; 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive; 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”*. Me nenin 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015, parashihet se *“ I punësuarin, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë : pika 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij; 1.2 .për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3 për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij”*. Ndërsa me nenin 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës parashihet *“I punësuarin, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt te fundit”*. Gjithashtu duke u bazuar në nenin 81 par.2 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive thuhet se: *“Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”*.

Nga provat e administruara dhe të cekura më lartë, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet të refuzohet në tërësi si e pabazuar, kjo për faktin se paditësit kërkesën e tij për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe pagat përcjellëse me rastin e pensionimit e ka mbështetur në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e cila marrëveshje në momentin e paraqitjes së padisë me datë 21.11.2019, nga ana e paditësit nuk ka qenë në fuqi ngase e njëjta ka qenë në

zbatueshmëri nga data 01.01.2015 deri më 31.12.2017. Nga vlerësimi i aktit që garanton pagesën e kompensimeve-shpërblimeve, Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, konstatohet se të njëjtit i ka pushuar fuqia e zbatimit, ngase saktësisht është rregulluar se çfarë periudhë kohore do të aplikohet. Ky akt ka pushuar të aplikohet që nga data 31.12.2017, kurse paditësi ka paraqitur padinë me datë 21.11.2019, andaj sipas bindjes së kësaj gjykate pasi që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive nuk ishte në fuqi apo nuk ishte vazhduar vlefshmëria e saj, atëherë kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe si e tillë gjykata e kishte refuzuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi, ashtu që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, konform nenit 450 të LPK-së, ngase autorizuari i palës së paditur nuk i ka kërkuar ato.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.1975/2019, me datë 13.02.2025**

**G j y q t a r i**

---

**Gëzim Shehu**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.